



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 74, datë 24.02.2020

**PËR PLOTËSIMIN E 1 (NJË) POZICIONI PRANË EUROJUST PËRMES
PROCEDURËS SË KOMANDIMIT TË PROKURORËVE**

Në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 184 të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 5 të ligjit nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, neneve 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 1 (një) pozicioni pranë EUROJUST si prokuror ndërlidhës përmes procedurës së komandimit.
2. Afati i komandimit do të jetë 2.5 vjet (dy vjet e gjysmë).
3. Ftohen të gjithë prokurorët që përmbushin kushtet e mëposhtme të shprehin interesin për t’u komanduar:
 - përmbushin kushtet për të qenë prokurorë apeli;
 - janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar;
 - kanë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të certifikuara;
 - kanë eksperiencë në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë;
 - nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar dhe që nuk janë të komanduar në një pozicion tjetër;
4. Shprehja e interesit duhet të paraqitet jo më vonë se 2(dy javë) nga Njoftimi për shprehjen e interesit në faqen zyrtare të Këshillit dhe të dorëzohet në adresën: ***Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa”, nr. 1 Tiranë.*** Mbi zarf duhet të shënohet “Shprehje interesi për komandim pranë EUROJUST”. Shprehja e interesit duhet të përmbajë: Letrën e motivimit ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4) si dhe një CV të përditësuar.
5. Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

~~GENT~~ IBRAHIMI

